

DEKLARATA E INFORMACIONIT PËR VAKSINËN

Shumë deklarata të informacionit për vaksinën janë të disponueshme në spanjisht dhe gjuhë të tjera. Shih www.immunize.org/vis

Hojas de información sobre vacunas están disponibles en español y en muchos otros idiomas. Visite www.immunize.org/vis

Vaksina e influencës (gripit) (e çaktivizuar ose e rikombinuar): Çfarë duhet të dini

1 Përse duhet të vaksinoheni?

Vaksina e influencës mund ta parandalojë influencë (gripin).

Gripit është një sëmundje ngjitëse dhe përhapet në Shtetet e Bashkuara çdo vit, zakonisht midis muajit tetor dhe maj. Çdokush mund të preket nga gripit, por për disa njerëz ai është më i rrezikshëm. Foshnjat dhe fëmijët, të moshuarit 65 vjeç e lart, gratë shtatzëna dhe ata me probleme të caktuara shëndetësore ose me sistem të dobësuar imunitar janë më të rrezikuar nga komplikacionet e gripit.

Infeksionet e pneumonisë, bronkitit, sinusit dhe të veshit janë disa nga shembujt e komplikacioneve të lidhura me gripin. Nëse keni një problem shëndetësor si sëmundje zemre, kancer ose diabet, sëmundja e gripit mund t'i përkeqësojë ato.

Gripit mund të shkaktojë ethe dhe të dridhura, dhimbje fyti, dhimbje muskujsh, lodhje, kollë, dhimbje koke dhe hundë të bllokuara ose me sekrecione të lëngshme. Disa njerëz mund të përjetojnë të vjella dhe diarre, megjithëse kjo është më e zakonshme tek fëmijët, sesa tek të rriturit.

Çdo vit mijëra njerëz në Shtetet e Bashkuara vdesin nga gripit dhe shumë të tjerë shtrohen në spital. Vaksina e gripit parandalon miliona sëmundje dhe vizita tek mjeku çdo vit.

2 Vaksina e gripit

Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) rekomandon që të gjithë nga moshë 6 muajsh e lart të vaksinohen çdo sezon gripit. Fëmijët nga 6 muaj deri në 8 vjeç mund të kenë nevojë për 2 doza gjatë një sezoni të vetëm gripit.

Të gjithë të tjerët për çdo sezon gripit kanë nevojë vetëm për 1 dozë.

Duhen rreth 2 javë që mbrojtja të zhvillohet pas marrjes së vaksinës.

Ka shumë lloje virusesh të gripit dhe ato ndryshojnë vazhdimisht. Çdo vit prodhohet një vaksinë e re e gripit për t'u mbrojtur nga tre ose katër viruse që mund të shkaktojnë sëmundje në sezonin e ardhshëm të gripit. Edhe kur vaksina nuk përputhet saktësisht me këto viruse, ajo përsëri mund të mbrojë disa.

Vaksina e gripit **nuk shkakton grip.**

Vaksina e gripit mund të jepet në të njëjtën kohë me vaksinat e tjera.

3 Flisni me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor

Tregojini ofruesit të vaksinës nëse personi që po e merr atë:

- Ka pasur **reaksion alergjik pas marrjes së një doze të mëparshme të vaksinës së gripit** ose ka ndonjë **alergji të rëndë, kërcënuese për jetën.**
- Ka pasur ndonjëherë **sindromën Guillain-Bare** (e njohur gjithashtu si GBS).

Në disa raste, ofruesi juaj i kujdesit shëndetësor mund të vendosë ta shtyjë vaksinimin e gripit për një vizitë tjetër.

Njerëzit me sëmundje të lehta të tilla si ftohje, mund të vaksinohen. Njerëzit që po kalojnë një sëmundje të lehtë ose të rëndë zakonisht duhet të presin derisa të shërohen, para se të marrin vaksinën e gripit.

Ofruesi juaj i kujdesit shëndetësor mund t'ju sigurojë më shumë informacion.

4 Rreziqet nga reaksioni i vaksinës

- Dhimbje, skuqje dhe ënjtje në pjesën e trupit ku merret vakcina; ethe, dhimbje muskulore dhe dhimbje koke mund të përjetojnë pas marrjes së vaksinës së gripit.
- Mund të ketë një rrezik shumë të vogël në rritje të sindromës Guillain-Barré (GBS) pas vaksinës së çaktivizuar të gripit (vakcina e gripit).

Fëmijët që e marrin vaksinën në të njëjtën kohë me vaksinën pneumokoksike (PCV13) dhe/ose DTaP mund të kenë pak më shumë gjasa të përjetojnë një krizë të shkaktuar nga ethet. Tregojini ofruesit tuaj të kujdesit shëndetësor nëse fëmija që po vaksinohet nga gripi ka pasur ndonjëherë një krizë të tillë.

Njerëzit ndonjëherë përjetojnë të fikët pas procedurave mjekësore, përfshirë vaksinimin. Tregojini ofruesit tuaj nëse ndiheni të trullësuar ose keni ndryshime të shikimit ose tingëllima në veshë.

Ashtu si me çdo ilaç tjetër, mundësia është tepër e vogël që një vaksinë të shkaktojë një reaksion të rëndë alergjik, dëmtim tjetër serioz ose vdekje.

5 Po, nëse ka ndonjë problem serioz?

Mund të ndodhë një reaksion alergjik pasi personi i vaksinuar të largohet nga klinika. Nëse vini re shenja si reaksion të rëndë alergjik (urtikarie, ënjtje e fytyrës dhe fytit, vështirësi në frymëmarrje, rrahje të shpejta të zemrës, marramendje ose dobësi) telefononi në nr. **911** dhe dërgojeni personin në spitalin më të afërt.

Për shenja të tjera që ju shqetësojnë, telefononi ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor.

Efektet anësore duhet të raportohen në Sistemin e Raportimit të Efekteve Anësore të Vaksinave (VAERS). Ofruesi juaj i kujdesit shëndetësor do të paraqesë këtë raport zakonisht, ose ju mund ta bëni vetë. Vizitoni faqen e internetit të VAERS në www.vaers.hhs.gov ose telefononi në nr. **1-800-822-7967**. *VAERS shërben vetëm për raportimin e efekteve dhe personeli i VAERS-it nuk ofron këshilla mjekësore.*

Programi Kombëtar i Kompensimit të Dëmtimeve nga Vaksinat (VICP) është një program federal që u krijua për të kompensuar njerëzit që mund të jenë dëmtuar nga vakcina të caktuara. Vizitoni faqen e internetit të VICP në www.hrsa.gov/vaccinecompensation ose telefononi në **1-800-338-2382** për të mësuar më shumë rreth programit dhe regjistrimit të një kërkesë. Ka një afat kohor për të regjistruar një kërkesë për kompensim.

7 Si mund të informohem më shumë?

- Pyesni ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor.
- Telefonojini departamentit shtetëror ose lokal të shëndetit.
- Kontaktoni Qendrën për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC):
 - Telefononi në nr. **1-800-232-4636 (1-800-CDC-INFO)** ose
 - Vizitoni faqen e internetit të CDC-së në www.cdc.gov/flu



Vaksina e aktivizuar e gripit

8/15/2019 | 42 U.S.C.  300aa-26
